

LIGJ
Nr. 29/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT
TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA E
TRANSMETIMIT 400 KILOVOLTË SHQIPËRI–KOSOVË (TIRANË–PRISHTINË)”,
NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 42 000 000 EUROSH**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 (dyzet e dy milionë) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.5.2018

Shpallur me dekretin nr. 10807, datë 8.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

KfW Bankengruppe, Postfach 111141, 60046 Frankfurt am Main

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtuar: Arben Ahmetaj, Ministër
Blv. “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
Drejtuar: Klodian Gradeci, Administrator
Autostrada Tiranë–Durrës, km 9, Yrshek, Kashar
Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar Datë: 20 dhjetor 2017
me Shqipërinë KfW Development
Zgjatja e afatit të Bank
disbursimit Sarah Bongard
Linja e transmetimit 400 Ref. Jonë: Bgh
kV Shqipëri–Kosovë Tel: +49 69 7431-2185
(Tiranë–Prishtinë) Faks: +4969 7431-2944
 Sarah.Bongard@kfw.de

Marrëveshje Huaje dhe Projekti

Data: 4 janar 2010
Shuma: EUR 42 milionë
BMZ-nr. 2008 65 196
Nr. i huasë 2531222
e amenduar (“Marrëveshja e Huas dhe e Projektit”)

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së Huas dhe Projektit të lartpërmendur dhe letrës tuaj të datës 14 nëntor 2017, si dhe korrespondencës vijuese për një zgjatje të afatit të disbursimit, si edhe një rregullim në emrin dhe adresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kemi kënaqësinë t’ju informojmë se jemi dakord për zgjatjen e afatit të disbursimit deri më 30 dhjetor 2018. Për të kontribuar në përfundimin me sukses të projektit, KfW-ja do të mbulojë në veçanti kostot shtesë të rifinancimit, të shkaktuara nga zgjatja e periudhës së disbursimit.

Si rrjedhojë, jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes së Huas dhe Projektit:

SEKSIONI A
Ndryshimi i Marrëveshjes së Huas
dhe Projektit:

Marrëveshja e Huas dhe e Projektit do të ndryshohet si më poshtë:

1. Termi “Ministria e Financave” fshihet dhe zëvendësohet me “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, kudo që përmendet në tekstin e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit.
2. Neni 3.2: Afati i fundit për kërkimin e disbursimeve fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë: “KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30 dhjetor 2018”.
3. Në nenin 13.2, adresa e Huamarrësit për njoftimet fshihet dhe zëvendësohet si më poshtë:

“Për Ministria e Financave dhe
Huamarrësin: Ekonomisë
 Blv. “Dëshmorët e Kombit”,
 nr. 3
 Tiranë/Shqipëri
 Faks: (+355) 4 222 8494”

SEKSIONI B
Dispozitat shtesë:

1. Kjo letër nuk ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe

Projekti, përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 10 (Kostot dhe tarifat publike), nenit 11.5 (Përputhshmëria), nenit 13.2 (Adresat), nenit 14.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet) dhe nenit 14.4 (Forma e shkruar dhe amendimet), nenit 14.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe nenit 14.9 (Mosmarrëveshjet ligjore – Arbitrazhi) të Marrëveshjes përfshihen në këtë letër, siç janë përcaktuar në mënyrë të plotë në të dhe sikurse referencat ndaj atyre dispozitave të Marrëveshjes janë referenca ndaj kësaj letre.

3. Kjo letër është hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin e përcaktuar më sipër, duke nënshkruar në një formë ligjërishit të detyrueshme dhe kthimin e një prej kopjeve pranë KfW-së.

Me respekt,

KfW

Jürgen Kern

Shef Divizioni

KfW Development Bank

Energjia dhe transporti

Evropa Juglindore dhe

Turqia

Sarah Bongard

Menaxhere e Projektit

KfW Development Bank

Energjia dhe transporti

Evropa Juglindore dhe

Turqia

E lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, më 5.3.2018

Për dhe në Republikës
së Shqipërisë

Emri: Arben Ahmetaj

Titulli: Ministër i

Financave dhe

Ekonomisë

Tiranë, më 12.2.2018

Për dhe në emër të

Operatorit të

Sistemit të Transmetimit

sh.a.

Emri: Klodian Gradeci

Titulli: